



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE



Procesverbali i Mbledhjes

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 23 prill 2026**

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1. Projektvendimi “Për krijimin, funksionimin dhe administrimin e fondit të gjelbër në kuadër të zhvillimit të territorit dhe hapësirave publike”.....	2
2. Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe fateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”.....	4
3. Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore të pyjeve”.....	6
4. Projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar”....	10
5. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 179 datë 26.2.2020 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992” “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore””, i ndryshuar.....	10
6. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar.....	11
7. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 203, datë 10.4.2019 e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagë””.....	12
8. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 21.12.2016, “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””.....	14
9. Projektligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”...	
10. Dokumenti “Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2026-2030”,..	
11. Dokumenti “Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve 2026-2030”,.....	16
12. Projektudhëzimi “Për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zonat publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore, peisazhi dhe procedura e përzgjedhjes së subjekteve”.....	18
Shtojcë:	
Të	pranishëm
.....	20

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 23 prill 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ. Mbledhja u zhvillua online, në platformën Teams , ku morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga *Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë*, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi zëvendësministrat pjesëmarrës, shoqatat e bashkive dhe të qarqeve, kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. Projektvendimi “ Për krijimin, funksionimin dhe administrimin e fondit të gjelbër në kuadër të zhvillimit të territorit dhe hapësirave publike”, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë u prezantua nga Znj, Artemis Poshi, Përgjegjëse, Sektori Juridik, Agjencia e Zhvillimit të Territorit e cila theksoi se projektvendimi del në kuadër të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i cili synon të forcojë komponentin e gjelbërimit në zhvillimet urbane dhe rurale, përmes vendosjes së detyrimeve konkrete për subjektet zhvilluese dhe krijimit të një instrumenti të ri administrativ dhe fizik, të quajtur “Fondi i Gjelbër i Pemëve”.

Qëllimi kryesor i këtij fondi është:

- ✓ rritja e sipërfaqeve të gjelbëruara;
- ✓ përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe mikroklimës urbane;
- ✓ rritja e cilësisë së jetës dhe mirëqenies së qytetarëve;
- ✓ garantimi i përfshirjes së elementeve të gjelbërimit në çdo zhvillim territorial.

Instrumentet kryesore të projektvendimit janë:

- ✓ Fondi i Gjelbër i Pemëve i cili funksionon si fond fizik me fidanë dhe pemë për mbjellje, që përdoret për gjelbërim dhe rehabilitim të hapësirave publike.;
- ✓ Detyrimi për mbjelljen e pemëve i lidhur drejtpërdrejt me lejet e ndërtimit dhe aktivitetet në hapësira publike (p.sh. 1 pemë për çdo 30 m² ndërtim, apo 1 pemë për tavolinë në hapësira publike);
- ✓ Deklarata e përgjegjësisë i cili është dokument i detyrueshëm që subjekti zhvillues duhet të depozitojë përpara marrjes së lejes së ndërtimit, ku garanton përmbushjen e detyrimeve për gjelbërim.
- ✓ Regjistri elektronik i gjelbërimit i cili qendron për monitorimin e mbjelljeve dhe mirëmbajtjes së tyre.

Projektvendimi ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë), duke rritur rolin e tyre në menaxhimin e gjelbërimit urban si;

- ✓ Rritje e përgjegjësi administrative. Bashkitë janë përgjegjëse për identifikimin dhe miratimin e zonave për mbjellje në territorin e tyre, në bashkëpunim me institucionet qendrore;
- ✓ Menaxhimi dhe mirëmbajtja e fondit të gjelbër. Njësitë vendore do të kenë rol kyç në administrimin praktik të pemëve të mbjella dhe mirëmbajtjen e tyre afatgjatë;
- ✓ Verifikimi dhe kontrolli. Strukturat vendore të gjelbërimit duhet të konfirmojnë përmbushjen e detyrimeve nga subjektet zhvilluese, si kusht për pajisjen me certifikatë përdorimi;
- ✓ Rritje e kapaciteteve monitoruese përmes regjistrit elektronik, bashkitë duhet të ndjekin në kohë reale mbjelljet, shpërndarjen dhe statusin e pemëve;
- ✓ Përfitime financiare dhe material. Në rastet kur kontributi realizohet në vlerë monetare, bashkitë përfitojnë fonde shtesë për gjelbërim dhe investime mjedisore;
- ✓ Menaxhimi i hapësirave publike. Bashkitë lidhen drejtpërdrejt me detyrimin për kontribut nga subjektet që shfrytëzojnë hapësirat publike (p.sh. bare, restorante), duke e kthyer këtë në një instrument zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky projektvendim krijon një mekanizëm të ri të integruar midis zhvillimit urban dhe mbrojtjes së mjedisit, duke e bërë gjelbërimin një detyrim ligjor dhe të matshëm. Roli i pushtetit vendor është thelbësor, pasi ai shndërrohet në aktorin kryesor për zbatimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e këtij sistemi, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e mjedisit urban dhe cilësisë së jetës së qytetarëve.

Komente;

Znj. Katerina Marku, Drejtor, Drejtorja e Mjedisit, bashkia Tirane shtroi komentet ne lidhje me Neni 2:

- ✓ Të përcaktohen qartë kriteret e klasifikimit të pemëve/fidanëve në lidhje me speciet dhe biodiversitetin.
- ✓ Të saktësohet mënyra e ruajtjes, vendndodhja dhe administrimi i stokut të fidanëve/pemëve para mbjelljes.

Neni 5 (Deklarata e përgjegjësisë):

- ✓ Të shtohet fjala “dorëzim” për unifikim terminologjik.
- ✓ Të kërkohet dokumentacion shoqërues (verifikim në terren/hartim) i nënshkruar nga strukturat përgjegjëse.

Neni 6 (Shfrytëzimi i hapësirës publike):

- ✓ Të harmonizohet me VKM nr. 224, datë 01.04.2026, për të shmangur mbivendosjet.
- ✓ Të qartësohet raporti i kontributit: 1 pemë për 1 karrige apo për 2 karrige.

Neni 8 (Shpërndarja e fondit):

- ✓ Të zëvendësohet termi “fondi pyjor” me “fondi i gjelbër”.
- ✓ Të shtohet në pikën 2 germa (d): përcaktimi i llojit të pemëve sipas zonës.

Znj. Poshi shpjegoi se në lidhje me përcaktimin e llojeve të fidanëve dhe pemëve, është saktësuar se kjo çështje rregullohet në nenin 3, ku parashikohet që përcaktimi i llojeve të bimësisë bëhet në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe zgjedhja e fidanëve/pemëve do të bazohet në karakteristikat territoriale dhe kushtet mjedisore të zones, si dhe propozimet do të shqyrtohen dhe reflektohen dhe do të bëhet harmonizimi dhe konsultimi me aktet përkatëse ligjore/nënligjore. Gjithashtu, shtoi se drafti i fundit e përcakton se do jetë një pemë e mbjellur për një tavolinë.

2. Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe fateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve”

Znj. Elana Rama, *Drejtor, Drejtoria e Mbetjeve, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve* prezantoi projektvendimin “Për miratimin e kriterëve, procedurave dhe fateve për zbatimin e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve për të gjitha rrymat e mbetjeve” i cili del, në zbatim të nenit 11, pika 2 të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, dhe synon miratimin e kriterëve dhe procedurave për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, përmirësimin e ripërdorimit, riciklimit dhe rikuperimit dhe reduktimin e mbetjeve që depozitohen në landfill, në përputhje me hierarkinë e mbetjeve dhe direktivat e BE-se.

Projektvendimi është i organizuar në 5 krerë, ku kryesoret janë:

- ✓ Grumbullimi i diferencuar është detyrim i zotëruesve të mbetjeve;
- ✓ Synohet parandalimi i përzierjes së mbetjeve në burim;
- ✓ Pajisjet dhe kontenierët duhet të jenë të përshtatshëm dhe të sigurt, të mbyllur dhe rezistent ndaj dëmtimeve, të lehtë për pastrim dhe dezinfektim, të identifikueshëm me ngjyra sipas standardeve të BE-së, të pajisur me etiketa të qarta për llojin e mbetjeve

Procedurat e grumbullimit janë;

- ✓ Ndarja në burim është detyrim i krijuesve të mbetjeve sipas planeve bashkiake.
- ✓ Mbetjet depozitohen në pika të caktuara nga bashkitë ose forma të tjera të organizuara.
- ✓ Grumbullimi realizohet sipas grafikut dhe kushteve teknike të çdo zone.

Operatorët raportojnë çdo vit deri më 15 shkurt pranë bashkive ndërsa bashkitë raportojnë deri më 28 shkurt pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Objektivat janë në përputhje me direktivat e BE-së dhe marrëveshjet e Shqipërisë ku deri në vitin 2030 synon 65% riciklim i mbetjeve të ambalazheve dhe deri në vitin 2035 synon rritje e mëtejshme e normave të riciklimit sipas rrymave të mbetjeve.

Projektvendimi është dërguar për konsultim në bashki dhe janë marrë sugjerime nga 6 bashki, kryesisht për çështje financiare. Mbështetja financiare nuk është objekt i drejtpërdrejtë i projektvendimit, por qeveria ka parashikuar mbështetje përmes fondeve dhe projekteve. Gjithashtu theksoi se ruhet transferta e pakushtëzuar për bashkitë dhe zbatohen, planifikohen projekte mbështetëse si;

- ✓ projekte të ekonomisë qarkulluese dhe gjelbërimit;
- ✓ projekte rajonale për menaxhimin e mbetjeve (Vlorë, Gjirokastrë, Kukës);
- ✓ projektet e financuara nga Banka Botërore dhe Banka Gjermane për Zhvillim;
- ✓ mbështetje me infrastrukturë (kontejnerë, mjete grumbullimi, etj.).

Projektvendimi synon të forcojë sistemin e menaxhimit të mbetjeve përmes rritjes së riciklimit dhe ndarjes në burim, harmonizimit me standardet e BE-së dhe mbështetjes së bashkive përmes projekteve dhe instrumenteve financiare ekzistuese.

Komente:

Z. Gjiguria, përfaqësues nga bashkia Himarë shtroi që janë disa sfida që do na dalin në vazhdim. Besoj jo vetëm neve si bashki Himarë, por gjithë bashkive të cilat kanë profilin tonë gjeografik. Ne kemi 20 fshatra të shpërndara në një territor malor bregdetar dhe disa raste goxha të vështirë. Frekuenca dhe oraret e grumbullimit janë të diferencuar. Jemi realist që duken vështirësitë e tyre për tu zbatuar dhe normalisht që do të rrisin edhe kostot për sa i përket ofrimit të këtij shërbimi, ku edhe në mbledhjen e mëparshme, një pjesë e mirë e bashkive ka kërkuar suport për sa i përket kostove që do të rriten dhe me sa shikoj nuk është reflektuar në projektin në fjalë. Kemi disa propozime konkrete dhe praktike që kemi futur në projekte në formë të përgjithshme për sa i përket ngjyrave për sa i përket kazanëve.

Z. Kojdheli theksoi se menaxhimi i mbetjeve është një proces i vazhdueshëm dhe afatgjatë, që nuk ka përfundim në kohë dhe kërkon përmirësim të vazhdueshëm. Një element kyç për suksesin e sistemit është tarifimi si instrument ekonomik dhe rregullator, i cili ndikon në uljen e gjenerimit të mbetjeve, nxit përgjegjshmërinë e qytetarëve dhe bizneseve dhe shërben si mekanizëm kontrolli dhe disiplinimi. Nëse kostoja e menaxhimit të mbetjeve nuk përballohet nga gjeneruesit e tyre sistemi nuk bëhet i qëndrueshëm afatgjatë dhe barra vazhdon të bjerë mbi buxhetin e bashkive dhe qeverisë.

Praktikat europiane dhe ndërkombëtare tregojnë se ndërgjegjësimi i qytetarit për koston e mbetjeve është thelbësor dhe parimi “ndotësi paguan” është baza e sistemit modern të menaxhimit të mbetjeve. Ky parim konsiderohet i domosdoshëm për të shmangur varësinë e vazhdueshme nga financimet publike dhe problemet strukturore në menaxhimin e mbetjeve.

Kjo qasje është reflektuar edhe në propozimet e paraqitura nga bashkitë, përfshirë bashkinë e Tiranës dhe të tjera, duke u orientuar drejt një modeli më të qëndrueshëm financiar.

Znj. Rama në përgjigje të saj theksoi se absolutisht jemi në linjë dhe politikat tona shkojnë drejt asaj që z. Kodheli i përmendim shumë të drejtë. Pra, ai që depoziton më shumë mbetje do të paguajë më shumë dhe ky është një mekanizëm të cilin e ka parashikuar ligjin në parim dhe ne do ta zhvillojmë më shumë me anë të vendimit të këshillit të ministrave dhe parashikohet në planet tona. Ndërsa, në lidhje me frekuencën e grumbullimit, ne përgjigje te z. Gjiguria, sigurisht që bashkitë inkurajohen të fillojë nga territori që gjeneron pjesën më të madhe të mbetjeve. Ndërsa, për pjesën rurale në politikat tona, duke pasur parasysh faktin që më shumë se 50 për qind e mbetjeve në shqipëri janë mbetje organike dhe inkurajohet fort, ngritja e qendrave kompostimit dhe bashkia juaj ka një shans shumë të mirë, pasi është ndër bashkitë e përfshira në projektin për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër.

3. Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore të pyjeve”

Z. Ylli Hoxha, Përgjegjës, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Ministria e Mjedisit, prezantoi projektligjin. “Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore të pyjeve”, propozuar nga Ministria e Mjedisit, i cili theksoi se projektligji ka për qëllim krijimin, organizimin dhe funksionimin e një shoqërie shtetërore aksionere për administrimin e fondit pyjor në Republikën e Shqipërisë.

Objektivat kryesore janë:

- ✓ menaxhim i qëndrueshëm i burimeve pyjore;
- ✓ përmirësimi i administrimit të fondit pyjor;
- ✓ mbrojtja e mjedisit dhe biodiversitetit;
- ✓ garantimi i përdorimit të qëndrueshëm të burimeve për brezat e ardhshëm.

Struktura e shoqërisë krijohet si shoqëri aksionere me 100% kapital shtetëror me përfaqësues nga shteti që është ministria përgjegjëse për mjedisin/pyjet me kapital fillestar 5 milion lekë të rinj.

Shoqëria ka kompetenca për administrimin dhe menaxhimin e fondit pyjor shtetëror, shfrytëzim të kontrolluar të burimeve pyjore, pyllëzim dhe ripyllëzim, parandalim dhe luftim të zjarreve në pyje, zhvillim të aktiviteteve ekonomike (druri, produkte jodrusore, bimë mjekësore, kredi karboni).

Organet drejtuese janë;

- ✓ Asambleja e përgjithshme e aksionarëve (organ vendimmarrës);
- ✓ Këshilli mbikëqyrës (5 anëtarë nga ministrinë përkatëse dhe pushteti vendor);
- ✓ Administratori (menaxhimi ekzekutiv i shoqërisë).

Detyrat e shoqërisë janë;

- ✓ Shoqëria harton planin e menaxhimit të pyjeve dhe planin e biznesit;
- ✓ Plani miratohet nga këshilli mbikëqyrës dhe ministria përgjegjëse;
- ✓ Njësitë e vetëqeverisjes vendore ruajnë rol koordinues sipas kompetencave ligjore.

Burimet financiare përfshijnë buxhetin e shtetit, të ardhurat nga aktivitetet ekonomike dhe financime dhe instrumente të tjera kombëtare/ndërkombëtare. Shoqëria bashkëpunon me Ministrinë e Mjedisit, Agjencitë Kombëtare të Mjedisit dhe Zonave të Mbrojtura, njësitë e vetëqeverisjes vendore. Shoqëria i nënshtrohet kontrollit dhe raportimit periodik dhe ka detyrim për informim publik dhe transparencë në veprimtari.

Komente;

Znj. Aida Shllaku, përfaqësuese nga bashkia Shkodër shtroi pyetjen në lidhje me nenin 8 dhe nenin 15, ku specifikohet se pasuria pyjore shtetërore transferohet, por shtoi se njësitë e qeverisjes vendore vazhdojnë të ushtrojnë kompetenca në koordinim. A mos duhet një ndarje më e qartë se cilat asete pyjore do mbeten në administrimin e bashkisë e cila do ti kalojnë shoqërisë. Në lidhje me daljen e të ardhurave, kryesisht nenin 14, ku citohet se ligji parashikon që shoqëria të gjenerojë të ardhura nga tregtimi i lëndës drusore apo bimëve medicinale dhe një pjesë e të ardhurave të pyjeve i kalojnë pikërisht shoqërisë. Funkzioni i parandalimit dhe luftimit të zjarreve në pyje kërkon koordinim të fortë ndërinstucional, pasi përfshin mobilizimin e burimeve njerëzore dhe strukturave bashkiake si dhe të mbrojtjes civile lokale. Është e nevojshme të përcaktohet një protokoll i qartë financiar dhe operacional, ku të sqarohet se si do të financohen ndërhyrjet në rast zjarresh, nëse shoqëria do të kompensojë bashkitë për shërbimet zjarrfikëse dhe mënyra e bashkëpunimit dhe ndërhyrjes në terren.

Referuar Neni 11 (Këshilli Mbikëqyrës), sugjerohet që, përveç përfaqësuesve të ministrive dhe pushtetit vendor, të përfshihet edhe një përfaqësues nga bashkitë, mundësisht me rotacion, duke marrë parasysh se bashkitë administrojnë sipërfaqe të mëdha pyjore. Kjo do të forconte përfaqësimin vendor dhe koordinimin praktik në terren.

Z, Brahimi, Drejtor, Ministria e Financave, theksoi se i mirret kompetenca bashkive dhe duhet korrigjitur ligji nr 139/2025 për administrimin e pyjeve bashkiake dhe funksioni decentralizohet dhe nuk e ushton funksionin më bashkia.

Z. Kojdheli, përfaqësues nga bashkia Tiranë theksoi se projektligji parashikon vetëm përfaqësim formal të bashkive, i cili nuk është i mjaftueshëm dhe sugjerohet që përfaqësimi vendor të trajtohet më thellë në terma institucionale në Këshillin Mbikëqyrës, duke forcuar rolin real të bashkive në vendimmarrje. Projektligji trajton pyjet si një aset uniform kombëtar, pa diferencim të qartë. Sugjerohet krijimi i një kategorizimi të qartë të pyjeve:

- ✓ pyje urbane;
- ✓ pyje peri-urbane;
- ✓ pyje rurale/malore.

Kjo do të lejonte që bashkitë të administrojnë më mirë hapësirat e tyre rekreative dhe publike (p.sh. parqet urbane dhe zonat turistike). Nuk është e qartë ndarja e përgjegjësisë në terren për mbrojtjen nga zjarret, për shfrytëzimin e pyjeve dhe për ripyllëzimin dhe menaxhimin praktik.

Kërkohet një ndarje më e qartë e roleve dhe kompetencave institucionale për zbatimin në terren. Projektligji perceptohet si i orientuar më shumë drejt logjikës tregtare dhe gjenerimit të të ardhurave, sesa drejt mbrojtjes së biodiversitetit, aksesit publik në pyje, funksionit social dhe mjedisor. Sugjerohet vendosja e indikatorëve të qartë mjedisorë dhe socialë për matjen e performancës së shoqërisë.

Projektligji mund të krijojë mospërputhje me “Paketën e Maleve”, e cila synon zhvillimin lokal të zonave pyjore nga bashkitë. Heqja e rolit pronësor/administrativ të bashkive mbi pyjet mund të kufizojë iniciativat zhvillimore locale, dobësojë instrumentet ekzistuese të zhvillimit ekonomik dhe turistik dhe të bëjë joefektive mekanizmat aktualë të bashkive për zhvillim të territorit

Kërkohet një rishikim i kujdesshëm nen për nen i projektligjit, për të siguruar qartësi institucionale dhe operacionale, balancë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, ruajtje të rolit të bashkive në zhvillimin territorial dhe pyjor dhe orientim të barabartë midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes mjedisore

Z. Hoxha theksoi se ndër shumë bashki përfshihet bashkinë Klos janë me performancën më të dobët në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor dhe kullor.

Znj. Farrici theksi se nuk është e pranueshme që të hiqen apo centralizohen kompetenca të njësive të vetëqeverisjes vendore, vetëm mbi bazën e faktit se disa bashki mund të kenë performancë të dobët. Kjo nuk mund të jetë arsye për delegjtimimin e funksioneve të tyre ligjore. Sugjeroi që të ketë bashkëpunim më të ngushtë institucional midis shoqatave të bashkive dhe Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, me qëllim mbështetjen e bashkive në rritjen e performances, forcimin e kapaciteteve menaxhuese dhe jo heqjen e kompetencave të tyre.

Në këtë kuadër, edhe grantet e performancës dhe instrumentet financiare mund të ishin përdorur për nxitjen e përmirësimit të menaxhimit të pyjeve nga bashkitë dhe jo për përjashtimin e tyre nga funksionet.

Projektligji, në formën aktuale, cënon parimin e autonomisë vendore, pasi kufizon kompetencat e bashkive në administrimin e territorit pyjor dhe bie ndesh me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe parimet e decentralizimit. Për këto arsye, vlerësohet se projektligji nuk mund të pranohet në formën aktuale, pasi krijon një zhvendosje të tepruar të kompetencave nga niveli vendor në atë qendror.

Z. Dedolli përfaqësues nga bashkia Klos theksoi së pari kemi trashëguar një fond pyjor nga ish-drejtoritë pyjore të kohës, të cilat nuk kalon asnjë database apo asnjë plan mbarështimi apo qoftë një referencë e caktuar, sepse bashkia Klos nuk disponon duke ditur historikun e bashkisë klos, jemi munduar që të krijojnë të ardhura për planin e menaxhimit për planin e mbarështimit, por nuk kemi patur mundësi. Kemi filluar të rregullojmë ligjshmërinë e të gjithë subjekteve minerare apo subjekteve që operojnë në fondin pyjor. Jemi në rrugën e duhur siç përmenda edhe paketën e maleve, si edhe me të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor. Pra, çfarë do të bëjë shoqëria tregtare më shumë se bashkia.

Znj. Pepa, përfaqësuese nga bashkia Fushë-arrëz shtroi se është konstatuar se bashkitë, përfshirë bashkinë Fushë-Arrëz (si rast reference), disponojnë çertifikata pronësie për fondin pyjor, të cilat përbëjnë një të drejtë të konsoliduar ligjore mbi këto territore. Ndaj, ngriti shqetësimin se çertifikatat e pronësisë nuk mund të jenë të kushtëzuara apo të zhvlerësohen dhe mbetet e paqartë se çfarë ndodh me këto të drejta në kuadër të projektligjit.

Nëse bashkitë janë tashmë pronare ligjore të këtyre zonave pyjore, shtrohet pyetja se si mund të ndryshohet ose reduktohet ky status dhe çfarë do të ndodhë me asetet dhe të drejtat e tyre ekzistuese. Gjithashtu theksohet se transferimi i pyjeve të bashkitë është bërë prej rreth 10 vitesh, por vlerësohet se ky proces ka pasur vështirësi dhe nuk ka funksionuar plotësisht siç pritej. Megjithatë, mbetet paqartësi se çfarë garancie ka që një rikthim ose ndryshim i ri institucional do të sjellë përmirësim më të madh dhe krahasuar me sistemin aktual ku bashkitë kanë njohuri direkte mbi territorin dhe nevojat lokale. Theksohet se bashkitë, pavarësisht sfidave (burime njerëzore, financim, kapacitete), janë më afër realitetit territorial dhe i njohin më mirë nevojat e pyjeve të tyre. Gjithashtu shprehu shqetësimin për interesin dhe arsyen e ndryshimit të

pronësisë/kompetencave nga bashkitë, si dhe rrezikun e zhvlerësimit institucional dhe financiar të tyre. Gjithashtu rikujtoi se proceset e mëparshme të transferimit të aseteve kanë qenë të shoqëruara me problematika administrative, kosto financiare dhe vështirësi në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe strukturave. Projektligji ngre shqetësime serioze lidhur me sigurinë juridike të pronësisë së bashkive mbi fondin pyjor, mungesën e qartësisë mbi trajtimin e certifikatave ekzistuese dhe rrezikun e zhvlerësimit të rolit dhe aseteve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, kërkohet qartësim i plotë ligjor dhe institucional, për të shmangur pasiguri mbi pronësinë dhe kompetencat ekzistuese të bashkive.

Z. Brahim i nuk dakordësoi me projektligjin duke shtuar se duhet riparë krejtësisht konfigurimi dhe koncepti i funksioneve kompetencave të pushtetit vendor.

Z. Kojdheli theksoi se nuk merret si referencë specifike bashkia Tiranë, pasi ajo ka plane dhe struktura mbarështimi pyjesh, por analiza mbetet në nivel të përgjithshëm për të gjitha bashkitë. Në frymën e decentralizimit, edhe nëse disa bashki mund të kenë nënperformancë në ushtrimin e kompetencave, kjo, nuk mund të justifikojë heqjen e kompetencave; sepse problemi është i shumë sektorëve, jo vetëm i menaxhimit të pyjeve. Zgjidhja e vërtetë nuk është centralizimi, por a) rritja e kapaciteteve të bashkive, b) forcimi institucional dhe teknik i tyre, c) një proces i gjatë dhe i vazhdueshëm zhvillimi. Në praktikë, shumica e shërbimeve publike (rreth 70%) ofrohen nga bashkitë, prandaj ato janë aktorë kryesorë në shërbimin ndaj qytetarëve dhe duhet të forcohen, jo të dobësohen.

Nga perspektiva e integritimit europian dhe zhvillimit të qëndrueshëm territorial kërkohet uniformitet dhe kohezion në zhvillimin e territorit, por pa cenuar rolin e pushtetit vendor. Projektligji mund të rishikohet duke ruajtur bashkitë si partnerë aktivë institucionalë, krijuar një shoqëri/strukturë kombëtare për valorizimin e pyjeve, duke lejuar bashkitë të jenë pjesë e vendimmarrjes (p.sh. në këshill mbikëqyrës), pa cenuar pronësinë dhe të drejtat e tyre mbi fondin pyjor. Heqja e pronësisë ose e kompetencave nuk zgjidh problemin e performances, përkundrazi, mund të ulë më tej aftësinë e bashkive për të vepruar dhe për të gjeneruar të ardhura.

Problemi i performancës duhet trajtuar përmes analizës së shkaqeve reale dhe rritjes së kapaciteteve dhe jo përmes centralizimit të funksioneve. Gjithashtu, theksoi se qasja më e drejtë është një model bashkëqeverisjeje dhe forcimi të pushtetit vendor, ku bashkitë mbeten pronare dhe menaxhere të territorit të tyre dhe përfshihen si partnerë në strukturat kombëtare, si dhe mbështeten për të përmirësuar performancën, në vend që të zëvendësohen.

Z. Hoxha theksoi se në lidhje me zjarret pafund reagimi i disa nga bashkitë është i dobët. Znj. Farrici theksoi se që bashkitë të mos përjashtohen nga modeli i propozuar, por të jenë pjesë e tij si aksionerë në shoqërinë shtetërore, duke ruajtur një rol aktiv në menaxhimin e pyjeve. Bashkitë që kanë performancë të mirë dhe e menaxhojnë në mënyrë efektive fondin pyjor duhet të kenë mundësi të gjenerojnë të ardhura dhe të përmirësojnë gradualisht sipërfaqet pyjore në territorin e tyre. Ngrihet pyetja mbi arsyen e centralizimit se pse duhet të transferohet menaxhimi në një shoqëri qendrore aksionere, kur një pjesë e bashkive mund të funksionojnë mirë dhe të jenë rentabël. Gjithashtu, procesi i miratimit të mos ecë menjëherë përpara, por të vendoset në fazë konsultimi dhe diskutimi të zgjeruar dhe të organizohen tryeza të përbashkëta konsultuese me

bashkitë, ku të diskutohen problemet e performances, të vendosen përgjegjësi të qarta për rastet e nënperformancës dhe njëkohësisht të hartohet një model më i mirë funksionimi.

Qëllimi është që procesi të ecë paralelisht në dy drejtime, në përmirësimin e performancës së bashkive dhe ndërtimi i një modeli institucional më të drejtë dhe funksional për menaxhimin e pyjeve. Zgjidhja e propozuar është një model bashkëpunimi dhe bashkëmenaxhimi, jo centralizimi i plotë, duke ruajtur rolin e bashkive si aktorë ekonomikë dhe menaxhues dhe duke forcuar performancën përmes dialogut dhe përgjegjshmërisë, jo përmes heqjes së kompetencave.

4. Projektvendimi “Për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar”

Znj. Dardana Grabovaj Drejtor, Drejtorja e Strehimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit prezantoi projektvendimin “Për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar” e cila bëri një prezantim të përmbledhur të projektvendimit për krijimin e bazës së të dhënave të strehimit social në nivel kombëtar, duke theksuar se ky është një akt me karakter teknik, i cili synon ndërtimin e një sistemi modern raportimi në kohë reale nga të gjitha bashkitë. Ajo sqaroi se ky sistem do të mundësojë pasqyrimin e plotë të nevojave për strehim, do të rrisë transparencën në përzgjedhjen e përfituesve dhe do të përmirësojë koordinimin ndërinstytucional, si dhe do të garantojë një shpërndarje më të drejtë të fondeve publike drejt shtresave në nevojë.

5. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 179 datë 26.2.2020 të Këshillit të Ministrave “ Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992” “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe te ndërmarrjeve shtetërore””, i ndryshuar

Znj. Dardana Grabovaj prezantoi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 179 datë 26.2.2020 të Këshillit të Ministrave “ Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992” “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe te ndërmarrjeve shtetërore””, i ndryshuar

Sipas saj, ndryshimet synojnë lehtësimin e procedurave për qytetarët, duke mundësuar përdorimin e dokumenteve alternative që provojnë jetesën në banesë, si dhe zhbllokimin e proceseve të pezulluara të privatizimit.

Komente:

Në vijim, znj. Brikena Leqejza, përfaqësuese e bashkisë Shkodër, ngriti shqetësimin lidhur me rastet e banesave të privatizuara para viteve '90, për të cilat qytetarët kanë kryer pagesat dhe disponojnë dokumentacion të vjetër, por nuk kanë arritur të përfundojnë regjistrimin në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Ajo sqaroi se në këto raste kërkohet një kontratë formale shitblerjeje përpara noterit, me qëllim regjistrimin përfundimtar të pronësisë, dhe kërkoi sqarim mbi mënyrën e veprimit në këto kushte.

Në përgjigje, znj. Dardana Grabovaj theksoi se projektvendimi parashikon procedurat e privatizimit nga fillimi deri në përfundim, por vlerësoi se çështja e ngritur mund të lidhet me problematika që tejkalojnë objektin e këtij akti. Ajo shtoi se raste të tilla duhet të trajtohen konkretisht dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse, duke lënë të hapur mundësinë e shqyrtimit të tyre nga grupi i punës.

Më pas, z. Mariglen Hoxha, përfaqësues i Bashkisë Fier, parashitroi problematika që lidhen me banesat e mbetura të paprivatizuara nga ish-punonjës të ndërmarrjeve të naftës. Ai sqaroi se vështirësitë lindin në rastet kur banesat rezultojnë të regjistruara në emër të pronarëve të mëparshëm, duke penguar realizimin e kontratave të shkëmbimit dhe të procedurave të privatizimit për familjet përfituese aktuale.

Në përgjigje, znj. Dardana Grabovaj sqaroi se projektvendimi parashikon mekanizma verifikimi në disa etapa kohore (1992, 2004 dhe gjendja aktuale), duke u dhënë mundësi bashkive të kryejnë verifikimet përkatëse dhe të vijnë me procedurat e privatizimit në favor të familjeve që aktualisht banojnë në këto objekte.

Gjatë diskutimit, z. Aldrin Dalipi ndërhyri për të orientuar debatin drejt përmbledhjes së problematikave dhe shmangies së diskutimeve të detajuara teknike, duke sugjeruar që çështjet specifike të trajtohen në vijim në mënyrë institucionale ndërmjet palëve përkatëse.

Në përfundim, u konstatua se nuk pati kundërshtime mbi projektvendimet e paraqitura, ndërsa çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e bashkive do të trajtohen në mënyrë të veçantë në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.

6. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar

Z. Aldi Dekavelli, Drejtor, Ministrisë Punëve të Brendshme prezantoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016 ‘Për Prefektin e Qarkut’, të ndryshuar”, duke theksuar se qëllimi kryesor i tij është forcimi i rolit të prefektit si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në territor, si dhe përfshirja më aktive e tij në koordinimin dhe ndërlidhjen e veprimtarisë së organeve qendrore në nivel vendor. Ai nënvizoi se prefekti merr një rol më gjithëpërfshirës edhe në bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore për adresimin e problematikave, përfshirë edhe emergjencat civile.

Në vijim, ai theksoi se projektligji synon të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet prefektit të qarkut, Policisë së Shtetit, Policisë Bashkiake dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e sigurisë publike dhe të qetësisë në komunitet.

Më tej, z. Dekavelli bëri të ditur se për përmbushjen e këtyre objektivave parashikohet krijimi i një strukture të re, konkretisht “Prefekti Detar”, i cili do të ketë rol në forcimin e qeverisjes dhe sigurisë në zonat bregdetare. Ai theksoi se rritja e zhvillimit turistik, aktiviteteve detare dhe rreziqeve mjedisore e bën të domosdoshme ngritjen e një strukture të specializuar për garantimin e zbatimit të politikave shtetërore në këto zona.

Në këtë kuadër, u sqarua se Prefekti Detar është përfaqësues i Këshillit të Ministrave për çështjet detare në njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë territor bregdetar. Ai emërohet dhe lirohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përkatës, ndërsa parashikohet

emërimi i dy prefektëve detarë që do të ushtrojnë funksionet e tyre sipas juridiksionit përkatës. Qendrat e prefekturave detare do të jenë në Durrës dhe Vlorë.

Në përfundim, z. Dekavelli paraqiti përgjegjësitë kryesore të Prefektit Detar, të cilat përfshijnë koordinimin në nivel qarku me institucionet qendrore dhe vendore për çështje që lidhen me sigurinë detare, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e burimeve detare dhe monitorimin e vijës bregdetare; raportimin periodik në Këshillin e Ministrave; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave sektoriale; si dhe drejtimin e strukturave dhe mekanizmave për menaxhimin e emergjencave civile detare dhe çështjeve të tjera në këtë fushë.

Komente:

Znj. Farrici u shpreh se projektligji në tërësi sjell një rritje të rolit të prefektit në fushën e sigurisë publike dhe mbrojtjes civile, si dhe vlerësoi pozitivisht parashikimin për ngritjen e prefekturave detare në Durrës dhe Vlorë, duke qenë se një strukturë e tillë nuk ka qenë e parashikuar më parë. Megjithatë, ajo ngriti disa paqartësi lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me rolin koordinues të prefektit, veçanërisht në raport me Policinë Bashkiake. Sipas saj, mbetet e paqartë se çfarë nënkupton konkretisht “koordinimi i veprimeve të Policisë Bashkiake” nga ana e prefektit.

Në këtë kontekst, znj. Farrici theksoi se, duke qenë se është në proces edhe një projektligj tjetër për Policinë Bashkiake, ku parashikohet që prefekti koordinon bashkëpunimin e saj me institucionet qendrore në nivel vendor, është e nevojshme të sigurohet përputhshmëri midis këtyre dispozitave. Ajo sugjeroi që në nenin 14 të reflektohet më qartë ky rol, duke u fokusuar në koordinimin me organet qendrore.

Gjithashtu, ajo propozoi heqjen e pikës 2 të nenit 14, e cila parashikon që prefekti konsultohet dhe bashkëpunon me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore për çështje problematike, me argumentin se kjo çështje është tashmë e trajtuar në nenin 15 të ligjit aktual, duke shmangur kështu mbivendosjen e dispozitave. Në përfundim, znj. Farrici theksoi nevojën për qartësim të rolit koordinues të prefektit në raport me Policinë Bashkiake dhe harmonizimin e dispozitave përkatëse në projektligj.

Z. Aldi Dekavelli, në përgjigje të komenteve të paraqitura, u shpreh se projektligji ndodhet në fazën e reflektimit të mendimeve, sugjerimeve dhe komenteve nga palët e interesuara. Ai theksoi se të gjitha vërejtjet e ngritura do të merren në konsideratë, me qëllim përmirësimin e draftit. Në vijim, ai sqaroi se pas përfshirjes së këtyre komenteve, do të përgatitet drafti final i projektligjit, i cili më pas do të përcillet për mendim dhe procedura të mëtejshme.

7. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 203, datë 10.4.2019 e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagë””

Z. Arben Cara, Drejtor i Përgjithshëm i MZSH-së, prezantoi projektvendimin në lidhje me përcaktimin e kriterëve dhe masës së përfitimit për pagesat e punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Ai sqaroi se ky projektvendim vjen si nevojë për përmirësimin dhe

qartësimin e trajtimit financiar të punonjësve me grada në këtë shërbim, në përputhje me Kodin e Punës dhe në vijim të zbatimit të vendimit ekzistues nr. 203, të vitit 2019.

Në vijim, ai theksoi se projektvendimi synon të adresojë paqartësitë e hasura gjatë zbatimit të vendimit aktual, duke saktësuar mënyrën e kompensimit për orët shtesë, punën gjatë natës, ditët e pushimit javor dhe festat zyrtare, si dhe duke vendosur një kufi maksimal vjetor për orët shtesë. Sipas tij, këto ndryshime synojnë të reduktojnë interpretimet e ndryshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe të garantojnë një trajtim të drejtë dhe të barabartë për punonjësit e këtij shërbimi.

Z. Cara paraqiti gjithashtu ndryshimet konkrete të propozuara, duke përfshirë përqindjet e reja të pagesave për orët shtesë, të diferencuara sipas natyrës së ditës dhe fashave orare, si dhe rregullimin e trajtimit për punonjësit e planifikuar dhe të paplanifikuar në grafik shërbimi. Ai bëri me dije se parashikohet edhe përcaktimi i një kufiri maksimal prej 200 orësh shtesë në vit për punonjësit operacionale, me përjashtime vetëm në raste të forcës madhore ose emergjencave civile.

Në argumentimin e projektvendimit, ai theksoi natyrën e veçantë dhe rrezikun e lartë të punës së zjarrfikësve, duke e cilësuar këtë shërbim si një forcë të parë reaguese në situata emergjente dhe me rëndësi kombëtare. Ai gjithashtu evidentoi problematikat e deritanishme në trajtimin financiar të punonjësve, duke përmendur se në disa raste këta të fundit i janë drejtuar gjykatave për të përfituar të drejtat e tyre, çka ka sjellë edhe kosto shtesë për buxhetin.

Në përfundim, z. Cara theksoi se ndryshimet e propozuara synojnë përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të punonjësve të MZSH-së, duke ndikuar edhe në uljen e largimeve nga ky shërbim, të cilat, sipas tij, kanë ardhur si pasojë e trajtimit jo të favorshëm dhe nivelit të ulët të pagave. Ai u shpreh i gatshëm për të dhënë sqarime të mëtejshme mbi projektvendimin.

Komente:

Znj. Farrici theksoi se projektvendimi vjen si rezultat i kërkesave të vazhdueshme nga ana e bashkive dhe përbën një reflektim të drejtpërdrejtë të nevojave të tyre, tashmë të përkthyer në një akt ligjor të rëndësishëm për funksionimin e tyre. Ajo nënvizoi se ky projektvendim është në përputhje me Kodin e Punës dhe ndihmon në krijimin e një kuadri më të qartë për trajtimin e punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Megjithatë, znj. Farrici ngriti një çështje lidhur me aspektin financiar të zbatimit të këtij vendimi. Ajo theksoi se, në raste të tilla kur ndërmerren ndryshime me ndikim financiar, zakonisht kostot mbulohe nga qeverisja qendrore, ndërkohë që në këtë rast, sipas saj, përgjegjësia duket se i lihet njësitë të vetëqeverisjes vendore.

Në përfundim, ajo kërkoi sqarime mbi këtë aspekt, konkretisht nëse kostot financiare të zbatimit do të mbulohe nga qeverisja qendrore apo do të mbeten përgjegjësi e bashkive.

Z. Arben Cara, në përgjigje të komentit mbi kostot financiare, u shpreh se këto kosto janë mbuluar edhe më parë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në bazë të fondeve të alokuara për to, përfshirë fondet e deleguara nga pushteti qendror. Ai theksoi se, bazuar edhe në përvojën e tij në funksione operacionale, ky vendim është zbatuar më parë pa krijuar probleme financiare për bashkitë, duke shtuar se nuk pritet që të ketë vështirësi edhe në të ardhmen për përballimin e

këtyre pagesave. Në vijim, z. Cara nënvizoi se ndryshimet e propozuara janë në përputhje me Kodin e Punës dhe përbëjnë një domosdoshmëri për t'u adresuar në mënyrë të menjëhershme. Ai theksoi gjithashtu natyrën e vështirë dhe të vazhdueshme të punës së zjarrfikësve, të cilët operojnë pa orar të përcaktuar, në kushte të vështira dhe shpesh me orë të papaguara ndër vite. Në përfundim, ai theksoi se ekziston një detyrim moral dhe institucional për të përmirësuar trajtimin e tyre financiar, duke garantuar pagesën e drejtë për punën e kryer.

8. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 21.12.2016, “Për kriteret e ecuresë dhe fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””

Z. Arben Cara, Drejtor i Përgjithshëm i MZSH-së, prezantoi projektvendimin duke theksuar se ai nuk shoqërohet me efekte financiare. Ai sqaroi se ndryshimet e propozuara lidhen kryesisht me përshtatjen sipas ligjit nr. 90/2014 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me rishikimin e emërtimeve të gradave në shërbimin zjarrfikës. Në vijim, ai bëri me dije se disa grada kanë pësuar ndryshim në emërtim, konkretisht nga “inspektor zjarrfikës” në “komisar zjarrfikës”, nga “kryeinspektor” në “komisar”, si dhe nga “komisar” në “kryekomisar”. Ai theksoi se, duke qenë se projektvendimi nuk ka ndikim financiar dhe përfshin vetëm ndryshime në emërtime, nuk paraqet problematika për zbatim dhe pritet të miratohet pa nevojë për diskutime të gjera. Në përfundim, ai u shpreh i hapur për çdo pyetje apo sqarim të mëtejshëm.

9. Projektligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

Znj. Jona Dervishaliaj, Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vijoi me prezantimin e projektligjit për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Znj. Dervishaliaj shprehu se projektligji është hartuar në kuadër të procesit të integritit evropian dhe si rrjedhojë synon përafrimin e plotë me Direktivën e Bashkimit Evropian të vitit 2019 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, duke sqaruar se drafti i parë është përgatitur dhe konsultuar me një grup pune të ngritur në ministri, si dhe me të gjithë aktorët që duhet të jenë pjesë e procesit të hartimit të këtij projektligji. Ajo theksoi se aktualisht ekziston një ligj për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe se, pas një vlerësimi të bërë së bashku me ministrinë e linjës, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, është rënë dakord që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të jetë institucioni lider për këtë projektligj, duke qenë se mbulon këtë fushë përgjegjësie. Risia kryesore e projektligjit qëndron në faktin se ai nuk do të përmbajë vetëm përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, por trajton në mënyrë më të gjerë aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve, duke synuar sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë qytetarët. Ajo sqaroi se përmirësimi i aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve publike dhe digjitale do të realizohet përmes vendosjes së standardeve të qarta në platformat dhe pajisjet digjitale, si dhe përmes një qasjeje më të strukturuar në këtë fushë. U theksua gjithashtu se një nga objektivat kryesore të projektligjit është reduktimi i fragmentimit institucional dhe sigurimi i një koordinimi më të mirë ndërmjet autoriteteve publike për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përputhshmërisë së produkteve dhe shërbimeve me kërkesat ligjore. Ajo shtoi se projektligji është një ligj kuadër dhe do të detajohet më tej në akte nënligjore, ku do të përcaktohen në mënyrë të detajuar të gjitha standardet përkatëse

të aksesueshmërisë. Drafti i projektligjit është bërë publik dhe është në proces konsultimi edhe me grupin e punës ndërinstytucional, dhe se synohet rritja e ndërgjegjësimit dhe forcimi i detyrimeve të operatorëve ekonomikë për përfshirjen e kërkesave të aksesueshmërisë në projektimin dhe ofrimin e produkteve dhe shërbimeve. Ajo shtoi se përmes këtij projektligji synohet gjithashtu promovimi i zhvillimit të produkteve për personat me aftësi të kufizuara, zhvillimi i teknologjive dhe i infrastrukturës përkatëse, si dhe ngritja e një sistemi efektiv monitorimi dhe raportimi, së bashku me forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe me shoqërinë civile për zbatimin e këtyre të drejtave. Projektligji parashikon detyrime konkrete për operatorët ekonomikë, duke përfshirë përshtatjen e pajisjeve teknologjike si kompjuterë, smartphone dhe tabletë, si dhe pajisjeve të vetë-shërbimit, si терминаlet automatike të biletave, bankomatët dhe kioskat elektronike, të cilat duhet të përmbushin standardet e aksesueshmërisë. Ajo shtoi se lista e mallrave do të detajohet më tej në një fazë të dytë, përmes akteve nënligjore dhe në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Znj. Dervishaliaj theksoi se, pas miratimit të projektligjit, kërkesat do të shtrihen edhe në shërbimet e komunikimit elektronik, duke përfshirë faqet e internetit dhe aplikacionet e kompanive, shërbimet e tregtisë elektronike, platformat e librave digjitalë, shërbimet audiovizive si streaming, si dhe shërbimet e transportit dhe ato bankare, duke nënvizuar se bëhet fjalë për një gamë të gjerë sektorësh që do të duhet të përshtaten gradualisht me kërkesat e aksesueshmërisë. Në lidhje me kostot, *Znj. Dervishaliaj* u shpreh se janë parashikuar tre opsione financiare për zbatimin e projektligjit, ku një opsion parashikon një kosto prej rreth 15.3 milionë lekë në vitin e parë dhe rreth 3.5 milionë lekë në vitin e dytë, ndërsa një tjetër opsion parashikon një kosto prej rreth 33.5 milionë lekë në vitin e parë. Ajo theksoi se këto vlera janë ende në fazë paraprake dhe do të rishikohen pas marrjes së komenteve nga institucionet e linjës dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. U sqarua se monitorimi i zbatimit të projektligjit parashikohet të realizohet përmes sistemeve elektronike ekzistuese, ku do të hidhen të dhëna mbi aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe përmes raportimit periodik nga autoritetet përgjegjëse. Gjithashtu është propozuar ngritja e një autoriteti të posaçëm për monitorimin e aksesueshmërisë, duke qenë se ministria ka rol kryesisht politikëbërës dhe nuk mund të mbulojë funksionin e monitorimit në terren.

Znj. Dervishaliaj theksoi nevojën për një periudhë tranzitore për zbatimin e projektligjit, duke propozuar një afat nga 3 deri në 10 vite për përshtatjen graduale me kërkesat e direktivës. Ajo shtoi se projektligji është shpërndarë pranë ministrive të linjës dhe se priten komentet e tyre sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, duke përfunduar se do të vijojë me prezantimin e dy planeve të tjera dhe se komentet për të tre dokumentet mund të mbledhen së bashku, duke qenë se ato janë të ndërlidhura.

10. Dokumenti “Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2026-2030”

Në vijim të prezantimit, *Znj. Jona Dervishaliaj* u shpreh se ministria, në përputhje me detyrimet e procesit të integritit evropian, ka vijuar me hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2026–2030, duke sqaruar se dokumenti është përgatitur në konsultim të ngushtë me ministrinë e linjës, organizatat e shoqërisë civile dhe njësitë e qeverisjes vendore. Ajo theksoi se, përpara hartimit të planit të ri, është përgatitur raporti i monitorimit për planin e mëparshëm 2021–2025, i bazuar në rezultatet e arritura dhe në pyetësorët e dërguar bashkive, si

dhe në takimet e zhvilluara gjatë muajve nëntor dhe janar, përmes të cilave janë marrë komente dhe sugjerime për planin e ri.

Znj. Dervishaliaj u shpreh se nga 136 aktivitete të parashikuara në planin e mëparshëm, 27 janë realizuar plotësisht, 59 janë në proces dhe rreth 50 nuk janë realizuar, duke theksuar se shkalla e përgjithshme e realizimit ka qenë rreth 47.8%. Ajo nënvizoi se, megjithëse ka pasur përpjekje nga institucionet në nivel qendror dhe vendor, janë evidentuar edhe sfida që reflektohen në këtë nivel realizimi dhe që janë marrë në konsideratë në hartimin e planit të ri.

Z. Aldrin Dalipi ndërhyri duke theksuar rëndësinë e rolit të qeverisjes vendore dhe kërkoi që prezantimi të përqendrohet në përfshirjen dhe detyrimet e bashkive në këtë plan.

Znj. Dervishaliaj u shpreh se plani mbështetet në kuadrin ligjor ekzistues, përfshirë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi dhe legjislacionin sektorial në fushat e mbrojtjes sociale, shëndetësisë, arsimit, punësimit, drejtësisë, transportit dhe planifikimit të territorit, si dhe në dokumentet strategjike në fuqi dhe procesin e përafrimit me Bashkimin Evropian. Ajo sqaroi se dokumenti është i lidhur me disa kapituj të acquis dhe se është hartuar përmes një procesi të gjerë konsultimi me ministritë e linjës dhe bashkitë. *Znj. Dervishaliaj* theksoi se plani i ri përfshin disa risi, si forcimi i qasjes ndërsektoriale, parashikimi i strukturave monitoruese për aksesueshmërinë në linjë me projektligjin e ri, integrimi më i plotë i standardeve të Bashkimit Evropian dhe kalimi drejt një qasjeje të bazuar në të drejta për personat me aftësi të kufizuara. Ajo shtoi se janë përcaktuar indikatorë performance dhe është rritur roli i institucioneve qendrore dhe i organizatave përfaqësuese në zbatim dhe monitorim, duke theksuar se ndikimi i planit pritet të jetë social, përmes rritjes së përfshirjes dhe pjesëmarrjes, uljes së barrierave dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës. Në vazhdim u shpreh se, sa i përket kostove, rreth 90% e financimit mbulohet nga buxheti i shtetit, ndërsa ekziston një hendek financiar që synohet të mbulohet përmes donatorëve dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, duke shtuar se plani përfshin fusha si aksesueshmëria, drejtësia, arsimi, punësimi, mbrojtja sociale, shëndetësia dhe përfshirja në jetën komunitare, për të cilat janë përcaktuar burimet përkatëse financiare. Përsa i përket rolit të bashkive, ato janë kryesisht institucione kontribuese, ndërsa institucionet lider për masat janë ministritë e linjës. Ajo përmendi si shembull objektivin për aksesueshmërinë në mjedisin e ndërtuar dhe në shërbime, ku parashikohet vlerësimi i situatës së aseteve publike, planifikimi i buxhetit dhe hartimi i planeve konkrete për përfshirjen e elementeve të aksesueshmërisë, me përfshirjen e institucioneve si ministritë përkatëse dhe institucione mbështetëse, përfshirë bashkitë dhe institucione teknike si universitetet. Bashkitë do të kenë rol edhe në raportimin e zbatimit të planit, si institucione kontribuese, ndërsa në fushën e transportit u theksua përmirësimi i aksesueshmërisë në shërbime dhe mjete transporti, përfshirë masa si mundësimi i udhëtimit falas për personat me aftësi të kufizuara, me përfshirjen e ministrive përkatëse, bashkive dhe operatorëve të shërbimeve.

Z. Aldrin Dalipi ndërhyri duke theksuar se dokumenti është shpërndarë dhe është i qartë për anëtarët, duke sugjeruar kalimin në pikën tjetër dhe fokusimin në ndryshimet kryesore.

11. Dokumenti “Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve 2026-2030”

Znj. Dervishaliaj vijoi me prezantimin e Planit Kombëtar të Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të komuniteteve rome dhe egjiptiane 2026–2030, duke sqaruar se dokumenti është përgatitur në vijim të planit të mëparshëm dhe në të njëjtën metodologji, duke përfshirë raportin e monitorimit dhe konsultime të gjera me institucionet dhe organizatat përkatëse. Në planin e mëparshëm janë arritur rezultate konkrete, si ulja e numrit të fëmijëve të paregjistruar, rritja e përfitimit nga ndihma juridike, përmirësime në shërbimet shëndetësore përmes ekipeve lëvizëse dhe mediatorëve, rritja e përfitimeve në strehim dhe subvencione, rritja e bursave në arsim dhe rritja e përfshirjes në punësim përmes programeve të integruara. Ndër risitë kryesore të planit përfshihen formalizimi i disa roleve përmes akteve nënligjore, synimi për regjistrim universal të lindjeve deri në vitin 2030, rritja e ndihmës juridike, prioritizimi i zgjidhjeve alternative në strehim, eliminimi i segregimit në arsim dhe përfshirja e gjuhës rome në kurrikul, si dhe zhvillimi i modeleve të reja në fushën e punësimit dhe ndërmjetësimit komunitar. Ajo shtoi se parashikohet ngritja e shërbimeve mobile në zonat e izoluara dhe forcimi i mekanizmave të reagimit në situata emergjente, si dhe përfshirja e parimit të antigjipsizmit në politikat publike.

Në vijim të diskutimeve, Z. Aldrin Dalipi u shpreh se mund të kalohej në sesionin e pyetjeve dhe diskutimeve të anëtarëve dhe ftoi znj. Adelina Farrici të merrte fjalën.

Komente:

Znj. Farrici, parashitroi pyetje lidhur me pjesën e aksesueshmërisë, duke kërkuar sqarim nëse projektligji do të rregullojë edhe aksesueshmërinë në infrastrukturën publike apo nëse kjo çështje do të trajtohet me një ligj tjetër të veçantë. Ajo ngriti gjithashtu shqetësimin lidhur me nenin 17 të projektligjit, që parashikon moszbatimin e detyrimeve në rastet kur ato përbëjnë barrë financiare joproporcionale për operatorin ekonomik, duke kërkuar sqarim mbi mënyrën e llogaritjes së kësaj barre dhe mungesën e një mekanizmi miratimi nga strukturat përgjegjëse.

Znj. Dervishaliaj sqaroi se kjo pjesë do të detajohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duke qenë se projektligji është ende në fazë draftimi dhe priten komentet nga institucionet përgjegjëse. Ajo theksoi se standardet që lidhen me infrastrukturën do të përfshihen në përputhje me kërkesat e direktivës, duke qenë se projektligji paraqet një kuadër të përgjithshëm që do të detajohet më tej në akte nënligjore.

Znj. Farrici ngriti më tej shqetësimin për barrën financiare që mund të sjellë projektligji për bashkitë, veçanërisht për bashkitë e vogla dhe të mesme, duke sugjeruar që kostot për zbatimin e tij të mbulohen nga buxheti i shtetit. Ajo vuri në dukje gjithashtu se në përbërjen e organit kombëtar me 17 anëtarë nuk përcaktohen qartë dy prej tyre dhe mungon përfaqësimi i pushtetit vendor. Gjithashtu, ajo theksoi se në projektligj nuk është përcaktuar struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e aksesueshmërisë së shërbimeve.

Në vijim, znj. Farrici paraqiti disa komente për Planin Kombëtar të Veprimit, duke u ndalur te komponenti i kujdesit shëndetësor. Në disa masa bashkitë janë parashikuar si institucione përgjegjëse, ndërkohë që në praktikë ato nuk kanë në varësi infermierët dhe mediatorët e shëndetit, ndaj nuk mund të konsiderohen institucione përgjegjëse, por vetëm lehtësuese të procesit.

Znj. Farrici u ndal gjithashtu te pjesa e arsimit dhe dialogut ndërkulturor, duke sugjeruar përfshirjen më të qartë të komuniteteve rome dhe egjiptiane dhe riformulimin e masave që lidhen me përjashtimin nga tarifat e çerdheve dhe kopshteve. Ajo theksoi se edhe në disa masa arsimore dhe sociale roli i bashkive duhet të rishikohet, pasi kompetencat në këto fusha i përkasin kryesisht qeverisjes qendrore. Ajo shtoi se edhe në pjesën e bursave dhe ndihmës ekonomike bashkitë e kanë të vështirë të jenë institucione përgjegjëse, ndërsa në fushën e punësimit ato mund të kontribuojnë përmes granteve për start-up dhe asistencës teknike, por sugjeroi që formulimi i aktiviteteve të mos krijojë kuota të ngurta për përfituesit nga komunitetet rome dhe egjiptiane.

Znj. Jona Dervishaliaj utheksoi se për mbikëqyrjen e shërbimeve është propozuar ngritja e një autoriteti të posaçëm, duke qenë se ministria ka rol politikëbërës dhe jo monitorues në terren. Ajo kërkoi që komentet të dërgohen me shkrim, në mënyrë që të shqyrtohen në detaj dhe të reflektohen në dokument, duke theksuar gjithashtu nevojën për respektimin e afateve të miratimit.

Në vijim, Z. Klaudio Taho, specialist, Bashkia Tiranë, u shpreh se Bashkia Tiranë e vlerëson nismën e ministrisë si vijimësi e planit të mëparshëm dhe theksoi se komentet e tyre janë në të njëjtën linjë me ato të paraqitura më herët, veçanërisht për sa i përket saktësisimit të kompetencave të vetëqeverisjes vendore dhe ndikimit financiar të disa masave. Ai theksoi se përjashtimi i plotë i bizneseve rome nga tarifat vendore duhet të shoqërohet me një analizë të qartë të kostos për bashkitë, duke qenë se më parë kjo masë ishte në nivel 50%. Gjithashtu, ai u ndal te nevoja për saktësimin praktik të disa masave që lidhen me sipërmarrjen sociale dhe menaxhimin e mbetjeve, në mënyrë që të jenë të zbatueshme në nivel vendor.

Znj. Dervishaliaj falënderoi për komentet dhe kërkoi që ato të dërgohen me shkrim për shqyrtim të mëtejshëm.

Në vijim, Z. Shkëlqim Allkaj, Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Programeve të Arsimit Parauniversitar, Ministria e Arsimit, paraqiti disa komente për dokumentin, duke theksuar nevojën për saktësimin e pjesës që lidhet me përfshirjen e gjuhës rome në kurrikulën e arsimit parauniversitar, si dhe për rishikimin e disa masave që lidhen me arsimin profesional dhe institucionet përgjegjëse. Ai theksoi se disa nga këto elemente kërkojnë qartësim të mëtejshëm në aspektin konceptual dhe institucional, në mënyrë që të jenë të zbatueshme në praktikë.

Znj. Dervishaliaj theksoi se komentet e Ministrisë së Arsimit do të reflektohen dhe se dokumenti do t'u ridërgohet institucioneve për bashkërendim, duke kërkuar që komentet të përcillen brenda afateve të përcaktuara.

Z. Aldrin Dalipi falënderoi pjesëmarrësit për diskutimet dhe, në mungesë të pyetjeve të tjera, mbylli këtë pikë të rendit të ditës dhe kaloi në pikën e fundit për konsultim.

12. Projektudhëzimi “Për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zonat publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore, peisazhi dhe procedura e përzgjedhjes së subjekteve”

Znj. Sonila Kora, Përgjegjëse, Sektori i Trashëgimisë Kulturore, prezantoi projektudhëzimin “Për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zonat publike me vlerë arkeologjike, historike, artistike, kulturore, peisazhi dhe procedura e përzgjedhjes së subjekteve” i cili mbështetet në ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe parashikon që rregullat që miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës.

Fokusi i projektaktit (4 drejtime); a) Tipologjia e aktiviteteve tregtare, b) Kushtet për zhvillimin e tyre, c) Kriteret për subjektet aplikante, d) Procedurat e aplikimit dhe shqyrtimit. Ndërsa, në lidhje me llojet e aktiviteteve tregtare që mund të ushtrohen janë; a) Shitje botimesh (katalogë, fletëpalosje), b) Suvenire dhe replika të pasurive kulturore, c) Shërbime guide dhe pritje vizitorësh, d) Shërbime kafeterie dhe ushqim i shpejtë.

Kushtet kryesore si vjon; a) Respektimi i planit të menaxhimit të pasurisë, b) Mbrojtja e integritetit dhe autenticitetit, c) Mos pengimi i aksesit publik dhe aktiviteteve kulturore, d) Kontribut në ruajtje dhe promovim. Kriteret për subjektet që aplikojnë janë; Të regjistruara ligjërisht, a) Të pajisura me licenca përkatëse, b) Të kenë kapacitete financiare dhe integritet, c) Të garantojnë qëndrueshmëri të aktivitetit.

Kriteret për produktet janë; a) Të jenë përfaqësuese të trashëgimisë kulturore, b) Replika, punime artizanale, produkte tradicionale, c) Botime me ISBN që promovojnë vlerat kulturore.

Procedura e aplikimit është; a) Paraqitje me dokumentacion të plotë, b) Shqyrtim nga ministria dhe institucionet vartëse, c) Afate të përcaktuara për përgjigje.

Vendimmarrja i takon;

Nga këshilla kolegjalë: a) Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore, b) Këshilli i Trashëgimisë Kulturore Materiale, c) Këshilli i Muzeve (kur është rast muzeu). Miratimi final me urdhër të ministrit. Detyrimet pas miratimit për subjektin janë; a) Pagesa për përdorimin e pasurisë, b) Respektim i kushteve të mbrojtjes, c) Raportim periodik, d) Monitorim nga institucionet përgjegjëse.

Roli i pushtetit vendor është;

- ✓ Jep mendim për aktivitetet në territorin e tij.
- ✓ Vlerëson përputhjen me strategjinë vendore.
- ✓ Mund të refuzojë nëse bie ndesh me vizionin lokal.

Komente;

Znj. Farrici shtoi se roli i bashkive duhet të jetë më vendimtar në miratimin e lejeve dhe jo dhe për sa kohë janë pronë në administrimin e tyre dhe jo të ngelet vetëm në shprehjen e mendimit

Znj. Kora teksoi se udhëzimi duhet të jetë gjithëpërfshirës, pasi detyrë e ministrisë dhe bashkive në ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurisë, por njëkohësisht edhe vënien e kësaj pasurie në dispozicion dhe në funksion të komunitetit.

Objektivi është që ne të mos kontribuojë vetëm në ruajtje, por pasurinë ta bëjmë gjeneruese të të ardhurave, patjetër pushteti lokal dhe komunitetin që jeton pranë tij janë përfituesit e parë të kësaj iniciative

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje të zhvilluar me datën 23 prill 2026

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
2	Arian Jaupllari	Zv/ministër	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
3	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
4	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
5	Fran Brahimi	Drejtor	Ministria e Financave
6	Agron Inanaj	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Lezhë
7	Ervis Moçka	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Vlorë

Bashkëlidhur mund të aksesoni linkun për aktin e diskutuar në mbledhjen e Këshillit Konsultativ datë 23 prill 2026

Bashkëlidhur gjeni linkun e projektakteve që u diskutuan

<https://qeverisjavendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2026/prill-2026/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ *E-mail:* keshilli.konsultativ@amvv.gov.al *Adresa:* **Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.**